



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT
I
AVOKATIT TË POPULLIT

Nr. 444/2021

**lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim
Financiar dhe Auditim**

Për: Z. Albin Kurti, kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës

Z. Hekuran Murati, ministër i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve

Kopje: Z. Armend Muja, kryesues i Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere

Z. Nexhat Kryeziu, kryesues i Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar

Z. Habit Hajredini, drejtor- Zyra për Qeverisje të Mirë-Zyra e Kryeministrit

Prishtinë, më 29 prill 2022

Qëllimi i raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është që t'i rekomandojë Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim dhe Auditim, lidhur me harmonizimin me Kushtetutën dhe me Ligjin nr.05-L/021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi të dispozitave të nenit 3, paragrafi 1, pika 1.13, dhe të nenit 33, paragrafi 3, me të cilat parashihet anëtarësimi në Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve i shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe të auditimit dhe pasojat e mosrespektimit të kërkesave për këtë anëtarësim.

Baza ligjore

2. Avokati i Popullit, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), me Ligjin nr. 05-L/019 për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.16/26, qershor 2015, Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Ligji për Avokatin e Popullit) dhe me Ligjin nr. 05-L/021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.16/26, qershor 2015, Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi) midis të tjerash, i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

2.1 *“Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”* (neni 132, paragrafi 1, i Kushtetutës);

2.2 *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”* (neni 135, paragrafi 3, i Kushtetutës);

2.3 *“Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.”* (neni 16, paragrafi 4, i Ligjit për Avokatin e Popullit);

2.4 *“Publikon raporte dhe bën rekomandime mbi politikat dhe praktikat për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë.”* (neni 16, paragrafi 15, i Ligjit për Avokatin e Popullit);

2.5 *“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.”* (neni 18, paragrafi 1, pika 1.2, i Ligjit për Avokatin e Popullit);

2.6 *“Të rekomandoj qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.”* (neni 18, paragrafi 1, pika 1.5, i Ligjit për Avokatin e Popullit);

- 2.7 “T’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.” (neni 18, paragrafi 1, pika 1.6, i Ligjit për Avokatin e Popullit);
- 2.8 “Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.” (neni 18, paragrafi 1, pika 1.7, i Ligjit për Avokatin e Popullit);
- 2.9 “Avokati i Popullit trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin sipas ligjit përkatës për Avokatin e Popullit.” (neni 9, paragrafi 1, i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi).
- 2.10 “Avokati i Popullit ka autorizim të hetoj ose të veprojnë mbi ndonjë ankesë të parashtruar ose me vetë-iniciativë (ex-officio) kur ka bazë për të dyshuar se ka ndodhur diskriminimi nga subjektet e sektorit publik.” (neni 9, paragrafi 2, pika 2.3, i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi).

Faktet dhe rrethanat e rastit

3. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit për Avokatin e Popullit, më 19 korrik 2021 pranoi ankesën e z. Bujar Krasniqit, drejtor ekzekutiv i Institutit për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (në tekstin e mëtejshëm: IKAF), në të cilën kërkohej shqyrtimi i papajtueshmërisë ligjore dhe i pasojave diskriminuese të nenit 3, paragrafi 1, pika 1.13, dhe të nenit 33, paragrafi 3, të Ligjit nr. 06-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.
4. Në ankesën e tij, IKAF-i theksonte se shoqata profesionale me status të organizatave joqeveritare është themeluar në vitin 2005 me qëllim të kryerjes së aktiviteteve edukative, përkatësisht për ofrimin e arsimit dhe certifikimit profesional në çështjet e kontabilitetit, auditimit dhe raportimit financiar. IKAF-i është licencuar në vitin 2013 në bazë të Ligjit nr. 04-L/014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, i cili asokohe ishte i vlefshëm. Licencimi i IKAF-it është bërë nga autoriteti kompetent - Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (KKRF), pas përmbushjes së kushteve të parapara me ligj. KKRF-ja ka konfirmuar se IKAF-i ka përmbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara me ligj dhe ka plotësuar standardet, udhëzimet dhe rekomandimet e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (në tekstin e mëtejshëm: FNK) dhe se anëtarët e shoqatës veprojnë në pajtueshmëri me Kodin e Mirësjelljes Profesionale dhe me Kodin e Etikës të FNK-së. Këto kushte kanë qenë të parapara me ligjin në fuqi në kohën e licencimit dhe kushte identike parasheh edhe ligji aktual në fuqi, Ligji nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim dhe Auditim, në nenin 33.
5. IKAF-i më tutje thekson se dispozita e ligjit aktual në fuqi, Ligji nr. 06/L-032, neni 3, paragrafi 1, pika 1.13, shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe të auditimit ua vendos kushtin e anëtarësimit të detyrueshëm në FNK.
6. IKAF-i tërheq vëmendjen në dispozitën e nenit 33, paragrafi 3, të Ligjit nr. 06/L-032, sipas të cilit përcaktohet se në rast të mospërmbushjes së kërkesës për anëtarësim në FNK sipas dispozitave të këtij ligji, shoqatës i revokohet licenca nga KKRF-ja.
7. IKAF-i thekson se detyrimi për t’u anëtarësuar në FNK, e cila është një shoqatë profesionale ndërkombëtare, nuk mund të jetë një kriter ligjor imperativ për një shoqatë profesionale, e cila është licencuar nga KKRF-ja.

8. Më tutje IKAF-i konsideron se dispozitat e nenit 3, paragrafi 1, pika 1.13, dhe të nenit 33, paragrafi 3, janë në kundërshtim me dispozitat e tjera të Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim dhe Auditim, konkretisht me dispozitat e neneve 22, 23, 24 dhe 25, të cilat i përcaktojnë funksionet dhe përgjegjësitë e KKRF-së, dhe të neneve 29 e 30, të cilat i përcaktojnë të drejtat individuale të kontabilistëve dhe të auditorëve.
9. IKAF-i thekson se shoqatat profesionale kosovare, të cilat ofrojnë veprimtari edukative për kualifikime profesionale në fushën e kontabilitetit dhe të auditimit, duhet të ofrojnë edhe shërbime arsimimi profesional në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit të parapara nga ana e FNK-së. Mirëpo respektimi i këtij kushti nuk mund ta imponojë detyrimin e anëtarësimit duke pasur parasysh se ai nuk ka efekt juridik, sepse mbikëqyrjen e shoqatave të kontabilistëve dhe të auditorëve e bën KKRF-ja.
10. Për më tepër, IKAF-i tërheq vëmendjen për faktin se të paktën një herë në pesë vjet shoqatat angazhojnë një kontabilist profesionist vendor me arsimim profesional, me provime, kualifikime dhe përvojë të ngjashme me ato të parashikuara me Ligjin nr. 06/L-032 për ta monitoruar zbatimin e standardeve dhe procedurave të përcaktuara me ligj dhe raporti i hartuar i dorëzohet KKRF-së.
11. IKAF-i i referohet edhe Udhëzimit Administrativ nr. 03-2014 për Procedurat e Mbikëqyrjes dhe Kontrollit të Cilësisë së Shoqatave të Licencuara, Firmave të Auditimit dhe Auditorëve Ligjorë, sipas të cilit IKAF-i ia dorëzon një raport vjetor KKRF-së për aktivitetet e tij, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e punës së anëtarëve të tij, duke e bërë të pacenueshëm mandatin e KKRF-së.
12. Duke pasur parasysh që dispozitat e përcaktojnë qartë autoritetin ligjor të KKRF-së në fushën e mbikëqyrjes së punës së shoqatave profesionale, IKAF-i konsideron se FNK-ja nuk ka asnjë përgjegjësi mbikëqyrëse, kurse precedenti i krijuar në nenin 3, paragrafi 1, pika 1.13, dhe në nenin 33, paragrafi 3, të Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim ka pasoja diskriminuese ndaj shoqatave dhe anëtarëve të tyre.
13. Po ashtu IKAF-i thekson se sipas nenit 29, paragrafi 1, dhe nenit 30, paragrafi 1, të Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim dhe Auditim, kontabilistët e licencuar duhet të jenë anëtarë të shoqatës profesionale, derisa e drejta e tyre për asociim në shoqata të tjera është diskrecionale. Prandaj IKAF-i konsideron se dispozitat e nenit 3, paragrafi 1, pika 1.13, dhe të nenit 33 të Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me dispozitën e nenit 44, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me të cilin garantohet liria e asociimit.
14. IKAF-i thekson se revokimi i licencës për shkak të mosanëtarësimit në FNK do të kishte pasoja të drejtpërdrejta për anëtarët e tyre. Numri i anëtarëve/kandidatëve të regjistruar për licencim nga IKAF-i është 3450 në periudhën 2013-2021, ndërsa në të njëjtën periudhë janë regjistruar 987 kandidatë për edukim të vazhdueshëm profesional. Në rast të heqjes së licencës së IKAF-it, anëtarët e saj do të humbnin kualifikimet profesionale dhe të drejtën për ta ushtruar profesionin.
15. IKAF-i po ashtu i ka parashtruar kërkesë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve ku kërkohet shqyrtimi dhe ndryshimi i nenit 3, paragrafi 1, pika 1.13, dhe i nenit 33 të Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim; këto kërkesa për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji i janë drejtuar edhe Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere të KKRF-së.

16. IKAF-i ka dhënë vërejtjet e mësipërme edhe gjatë procesit të hartimit të Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, por ato nuk janë marrë parasysh.
17. Po ashtu IKAF-i e ka prezantuar dokumentacionin e korrespondencës me FNK-në, me të cilin që nga viti 2015 kërkon hyrjen e IKAF-it në këtë federatë. Gjithashtu, sipas udhëzimeve të FNK-së, IKAF-i i është drejtuar Shoqatës së Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar të Kosovës (SCAAK) me kërkesë për sponsorizim për pranim në FNK, sepse sipas politikave të kësaj federate, kërkohet që një anëtar i ri të sponsorizohet nga ana e një shoqate homologe vendase, që është anëtare e FNK-së.
18. IKAF-i konsideron se dispozitat e nenit 3, paragrafi 1, pika 1.13, dhe të nenit 33 të Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim janë në kundërshtim me nenin 44 dhe me nenin 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me dispozitat e Ligjit nr.05-L/021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, prandaj propozon të shqyrtohet pajtueshmëria e neneve kontestuese me Kushtetutën dhe me Ligjin nr.05-L/021 për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe të kërkohen ndryshime ose shfuqizime të nenit 3, paragrafi 1, pika 1.13, dhe të nenit 33 të Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Instrumentet ligjore relevante

19. Ekzistojnë një sërë instrumentesh ligjore që rregullojnë këtë çështje, por duke mos u kufizuar në:
 - 19.1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 21 [Parimet e Përgjithshme], definojnë: *“1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. 2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë. 3. Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve. [...]”*
 - 19.2 Kushtetuta në nenin 24 [Barazia para Ligjit] parasheh: *“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. [...]”*
 - 19.3 Kushtetuta në nenin 44 [Liria e Asociimit], paragrafi 1, definojnë: *“1. Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.”*
 - 19.4 Kushtetuta në nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushttrimi të Profesionit], definojnë: *“1. E drejta e punës garantohet. 2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.”*
 - 19.5 Kushtetuta në nenin 49 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], definojnë: *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë*

Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

20. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (4 nëntor 1950) (në tekstin e mëtejshëm: Konventa) është dokument juridik i zbatueshëm drejtpërdrejt në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 22) dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjit dhe të akteve të tjera të institucioneve publike.

20.1 Neni 14 i Konventës definton: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në cilindo shkak [...]”*

21. Neni 1 i Protokollit 12 të Konventës thekson: “*Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit: 1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër. 2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsytet e parashikuara në paragrafin 1.”*

22. Ligji nr. 06/1-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim rregullon sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar të shoqërive tregtare, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar (KKRF), kërkesat për auditim, kualifikimet për kontabilistë profesionalë, licencimin e auditorëve dhe firmat vendore e të huaja të auditimit, si dhe organizatat profesionale të kontabilitetit (neni 1, paragrafi 1), prandaj e definton si në vijim:

22.1 Neni 3, paragrafi 1, pika 1.13, i Ligjit nr. 06/1-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim parasheh: “*Shoqatë profesionale e kontabilitetit dhe auditimit - organizatë jofitimprurëse, jo-qeveritare e kontabilitetit dhe auditimit e cila brenda periudhes tre (3) vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij Ligji bëhet anëtare monitoruese, ndërsa brenda pesë (5) vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji bëhet anëtare me të drejta të plota e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK), dhe i shërben interesit publik nëpërmjet zbatimit të Deklarimeve për Obligimet e anëtarësimit në zhvillimin e profesionistëve të kontabilitetit dhe auditimit, dhe e cila përcakton dhe zbaton standardet etike dhe profesionale të cilat në vete ngërthejnë kërkesat fillestare dhe të vazhdueshme të arsimit profesional për kontabilistë dhe auditorë. Për shoqatat e themeluara pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, afatet vlejné nga data e licencimit nga KKRF.”*

22.2 Neni 22, paragrafi 1, i Ligjit nr. 06/1-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim i përcakton funksionet e KKRF-së: “*1. Funksionet e KKRF-së janë: 1.1. të mbikëqyrë zbatimin e këtij Ligji dhe akteve nënligjore që miratohen në bazë të këtij Ligji, dhe të marr veprime mbi mbikëqyrjen e zbatimit dhe masa disiplinore për moszbatim të duhur; 1.2. të aprovojë SNK-të në përputhje me SNK-të aprovuara nga BSNK-ja dhe legjislacionit përkatës të BE-së; 1.3. të aprovojë, të mbikëqyrë dhe zbatojë standardet e auditimit në pajtim me SNA-të dhe legjislacionit përkatës të BE-së; 1.4. të licencojë, të mbajë dhe të publikojë regjistrin e auditorëve, firmave audituese dhe shoqatave; 1.5. të miratojë standardet e etikës profesionale, cilësinë e brendshme të firmave të auditimit;*

dhe 1.6. të nostrifikojë certifikatat ndërkombëtare të auditorëve dhe kontabilistëve.”

- 22.3 Neni 23, paragrafi 1, i Ligjit nr. 06/l-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim përcakton komisionet e KKRF-së: *“1. Me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të dispozitave të këtij Ligji, KKRF-ja themelon komisione si në vijim: 1.1. komisioni për standardet e kontabilitetit dhe auditimit; 1.2. komisioni për licencim të auditorëve, firmave të auditimit dhe shoqatave; 1.3. komisioni për hetime dhe disiplinë.”*
- 22.4 Neni 24, paragrafi 1, i Ligjit nr. 06/l-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim parasheh themelimin e Bordit për Mbikëqyrje Publike, brenda KKRF-së: *“KKRF-ja themelon Bordin për Mbikëqyrje Publike (Bordi), i cili funksionon si krah ekzekutiv i KKRF-së. Bordi ka përgjegjësinë për mbikëqyrjen e: 1.1. arsimimit të vazhdueshëm; 1.2. sistemeve të sigurimit të cilësisë; dhe 1.3. sistemeve hetuese dhe administrative disiplinore.”*
- 22.5 Neni 25, paragrafi 1, i Ligjit nr. 06/l-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim përcakton Mbikëqyrjen e Shoqatave të Kontabilistëve dhe Auditorëve Ligjorë, si në vijim: *“1. KKRF-ja kërkon nga shoqatat që të prezantojnë këto dokumente: 1.1. planin e aktiviteteve që përfshin përmbushjen e kërkesave që dalin nga ky Ligj dhe nga obligimet lidhur me anëtarësinë në FNK; 1.2. kopje të kodit të etikës; 1.3. raportin e shoqatës që dëshmon programin për sigurimin e cilësisë dhe aktivitetet e ndërmarra në këtë fushë gjatë vitit raportues; 1.4. raportin në lidhje me rezultatet e hetimeve të shoqatës përfshirë edhe procedurat disiplinore; dhe 1.5. raport se si programi për kualitetin e shoqatës i plotëson kërkesat legjisacionit përkatës.”*
- 22.6 Neni 29, paragrafi 1, i Ligjit nr. 06/l-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim definon: *“1. Personi i kualifikuar si kontabilist i certifikuar nga një shoqatë, i cila është anëtar me status të rregullt pranë një shoqate të tillë, ka të drejtë të përdor titullin “kontabilist i certifikuar.”*
- 22.7 Neni 30, paragrafi 1, pika 1.4, i Ligjit nr. 06/l-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim parasheh: *“Për t’u licencuar si auditorë ligjor nga KKRF-ja, kandidatët duhet të përmbushin kushte si në vijim: [...] 1.4. të jenë anëtar të një shoqate në Kosovë; [...]”*
- 22.8 Neni 33, paragrafi 3, i Ligjit nr. 06/l-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim përcakton: *“1. Shoqatat licencohen nga KKRF-ja, me përmbushjen e këtyre kushteve: 1.1. KKRF-ja duhet të sigurohet se shoqata ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas këtij Ligji si dhe ka plotësuar të gjitha standardet, udhëzimet dhe rekomandimet e nxjerra nga FNK-ja, për shoqatat anëtare të saj; 1.2. KKRF-ja duhet të sigurohet se anëtarët e çdo shoqate të veprojnë në pajtueshmëri me kodin e mirësjelljes profesionale dhe me kodin e etikës së FNK-së. 2. Së paku një (1) herë në pesë (5) vite shoqatat angazhojnë një kontabilist profesional nga një vend që ka arsim, provime dhe kualifikim profesional ose një shoqatë profesionale në fushën e Kontabilitetit dhe Auditimit dhe kërkesë të përvojës ngjashëm me ato të përcaktuara me nenet*

e këtij Ligji për të mbikëqyrur zbatimin e standardeve dhe procedurave siç përcaktohet me këtë ligj. 3. Në rast të mos përmbushjes së kërkesës për anëtarësim në FNK sipas dispozitave të këtij Ligji, shoqatës i revokohet licenca nga KKRF.”

23. Për zbatimin e Ligjit nr. 06/l-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, KKRF-ja ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ nr. 03-2014 për Procedurat e Mbikëqyrjes dhe Kontrollit të Cilësisë së Punës së Shoqatave të Licencuara, Firmave të Auditimit dhe Auditorëve Ligjorë, i cili në nenin 20 parasheh: *“Subjektet e rregullores janë të obliguara që për nevojat e mbikëqyrjes të ofrojnë në KKRF, një herë në vit, e më së voni deri me 30 qershor të vitit vijues, për vitin paraprak, së paku të dhënat vijuese: strukturën e pronësisë (pronarët e akcioneve/ raportet afariste) blerjet ose ndryshimet në akcionet e kualifikuara; - strukturën qeverisëse [...] numrin e anëtarësisë (numri i përgjithshëm, numri i auditorëve të certifikuar, auditorëve ligjor, kontabilistëve të certifikuar, numri ligjëruesve, fondi i orëve, edukimi i vazhdueshëm, organizimi i provimeve dhe kalueshmëria, etj); të punësuarit (numri i përgjithshëm, nga kjo numri i auditorëve ligjor, numri i asistentëve, numri i personelit administrativ, statusi i të punësuarëve për secilën kategori të të punësuarëve); [...].”*
24. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi parasheh një kornizë të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në Kosovë:

24.1 Neni 1 i Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi parasheh: *“1. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimi në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.”*

24.2 Neni 2 i Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi parasheh: *“Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me: [...] 1.4. anëtarësimin dhe përfshirjen në organizata të punëtorëve ose të punëdhënësve apo në çdo organizatë tjetër anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesion të caktuar, përfshirë edhe përfitimet që mundësohen nga organizatat e tilla.”*

24.3 Neni 3 i Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi përcakton konceptin e diskriminimit, si në vijim: *“1. Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilëdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji. 2. Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të*

zhvleftësorë ose cenorë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.”

24.4 Neni 4 i Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi definon llojet e trajtimit të pabarabartë: “1. Llojet e trajtimit të pabarabartë janë si në vijim: [...] 1.7. Diskriminimi në bazë të asociimit - konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, shënjestrimi i personave që nuk i përkasin një grupi të caktuar por, që janë palë të treta që asociohen me ato grupe; [...].”

24.5 Neni 8 i Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi definon: “Të gjitha institucionet duhet të veprojnë në përputhje me parimet e këtij Ligji, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit.”

Analiza ligjore

25. Duke pasur parasysh kërkesën për përfshirjen në FNK të Shoqatave Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit të Kosovës, të imponuar me dispozitat e nenit 3, paragrafi 1, pika 1.13, të Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitetin, Raportimin Financiar dhe Auditimin dhe pasojat e mundshme nga mospërbushja e anëtarësimit në këtë federatë që çon në heqjen e licencës së shoqatës, të parashikuar në nenin 33, paragrafi 3, të Ligjit nr. 06/L-032, Avokati i Popullit do ta analizojë këtë çështje nga aspekti i respektimit të të drejtave dhe të lirive të njeriut si dhe të legjislacionit kundër diskriminimit, duke pasur parasysh parimin e ligjshmërisë dhe të sigurisë juridike.

26. Parimi i ligjshmërisë është norma themelore mbi bazën e së cilës ndërtohet i gjithë sistemi juridik. Ky parim garanton sundimin e ligjit dhe shmangien e arbitraritetit për ta arritur respektimin e drejtësisë dhe të sigurisë juridike. Parimi i ligjshmërisë nënkupton që organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, me legjislacionin në fuqi si dhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.¹ Me këtë parim definohet obligimi i organeve të administratës publike që gjatë kryerjes së veprimtarive administrative të punojnë dhe të vendosin në përputhje me ligjin. Për më tepër, kjo është e parashikuar në Kushtetutë, e cila përcakton: “Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.”²

27. Parimi i ligjshmërisë është i lidhur ngushtë me parimin e sigurisë juridike, mbi bazën e të cilit shteti i së drejtës e siguron konfidencialitetin e qytetarëve ndaj shtetit dhe pandryshueshmërinë e ligjit nëpërmjet procedurave të organeve administrative. Ky parim konsiston ndër të tjera në saktësinë, në qartësinë dhe në qëndrueshmërinë e tërë rendit juridik të shtetit, pra jo vetëm në norma të caktuara. Kërkohej që i gjithë rendi juridik të jetë i kuptueshëm, i parashikueshëm dhe jo kontradiktor.

¹ Sipas nenit 4, paragrafi 1, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 7.

28. Si rezultat i asaj që u tha më sipër, të gjitha dispozitat e Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim duhet të harmonizohen me Kushtetutën dhe me rregulloret ligjore pozitive, duke përfshirë edhe rregulloret që e ndalojnë diskriminimin.
29. Kushtetuta parashikon shprehimisht se është detyrim i të gjitha organeve t'i respektojnë të drejtat dhe liritë e të tjerëve dhe se çdokush e ka të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.³ Ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë dhe të përfshihet në legjislacionin që ka të bëjë me organizatat profesionale të kontabilistëve dhe të auditorëve.
30. Për më tepër, Kushtetuta e mbron dhe garanton lirinë e asociimit, e cila përfshin të drejtën për të qenë ose jo anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.⁴
31. Kushtetuta gjithashtu garanton të drejtën për të punuar dhe për të ushtruar një profesion,⁵ i cili u mundëson personave të angazhohen në veprimtari prodhuese në profesionin për të cilin janë të kualifikuar dhe të kontribuojnë në zhvillimin dhe në përparimin e shoqërisë.
32. Në përputhje me këto dispozita kushtetuese, diskrecioni i IKAF-it është që të jetë anëtar i FNK-së, ndërsa e drejta e anëtarëve të tij është të ushtrojnë profesionin e kontabilistit dhe të auditorit.
33. Profesionin e kontabilistëve dhe të auditorëve në Kosovë rregullohet me Ligjin nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2019. Në pajtim me dispozitat e këtij ligji, KKRF-ja licencën, mban dhe publikon regjistrin e auditorëve, firmave të auditimit dhe shoqatave.⁶ Roli i KKRF-së është që të kujdeset që parakushtet për profesionin e kontabilistit dhe të auditorit të bëhen përmes licencimit të Shoqatës së Kontabilistëve dhe Auditorëve në Kosovë, dhe mbikëqyrjes së kryerjes së profesionit të tyre. Rrjedhimisht, KKRF-ja ka licencuar IKAF-in si një shoqatë profesionale që ofron arsim dhe certifikim për kontabilistët dhe auditorët.
34. Në bazë të ligjit, KKRF-ja kryen aktivitetet e veta përmes punës së Komisionit për Standardet e Kontabilitetit dhe Auditimit, Komisionit për Licencimin e Auditorëve, Firmave të Auditimit dhe Shoqatave dhe Komisionit për Hetime dhe Disiplinë.⁷ Bordi për Mbikëqyrje Publike i KKRF-së mbikëqyr arsimimin e vazhdueshëm, sistemin e sigurimit të cilësisë, menaxhimin dhe sistemin e sigurisë dhe sistemin administrativ disiplinor, duke siguruar kështu përshtatshmërinë dhe disiplinën e kontabilistëve dhe auditorëve.⁸ Për të kryer mbikëqyrjen, shoqatat janë të obliguara t'ia dorëzojnë KKRF-së një plan veprimi, një kopje të kodit të etikës, një raport të shoqatës që dëshmon programin për sigurimin e cilësisë dhe aktivitetet e ndërmarra në këtë fushë gjatë vitit raportues, një raport për aktivitetet hetuese dhe procedurat disiplinore dhe një raport mbi programin e cilësisë së shoqatës.⁹

³ Kushtetuta, neni 24.

⁴ Po aty, neni 44.

⁵ Po aty, neni 49.

⁶ Ligji nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 22, paragrafi 1, pika 1.4, dhe neni 33, paragrafi 1.

⁷ Po aty, neni 23, paragrafi 1.

⁸ Po aty, neni 24, paragrafi 1.

⁹ Po aty, neni 25, paragrafi 1.

35. Mbikëqyrja e paanshme e aktiviteteve të Shoqatave të Kontabilistëve dhe Auditorëve sigurohet me detyrimin e shoqatës që së paku një herë në pesë vjet shoqatat të angazhojnë një kontabilist profesional nga një vend që ka arsim, provime, kualifikim profesional dhe përvojë të ngjashme me Kosovën, me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të standardeve dhe procedurave të vendosura me Ligjin nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.¹⁰
36. Udhëzimi Administrativ nr. 03/2014 për Procedurat për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Shoqatave të Licencuara, Firmave të Auditimit dhe Auditorëve Ligjorë nënvizon rolin mbikëqyrës të KKRF-së, sepse përshkruan në detaje se çfarë duhet të përmbajë raporti vjetor i dorëzuar nga shoqatat.¹¹
37. Certifikimin e kontabilistëve e kryen Shoqata e Kontabilistëve dhe në mënyrë që KKRF-ja të mundë t'i licencojë auditorët, ata duhet të jenë anëtarë të shoqatës.¹² Me këtë nënvizohet roli kyç i shoqatave profesionale të Kosovës në profesionin e kontabilistit dhe të auditorit.
38. Duke pasur parasysh kompetencat e listuara të KKRF-së, nuk është e qartë se çfarë roli do të luante obligimi i shoqatës për t'u anëtarësuar në FNK në mbikëqyrjen dhe në ushtrimin e profesionit të kontabilitetit në Kosovë. Imponimi i këtij kushti është i pakuptimtë, sepse nuk është evident qëllimi i anëtarësimit të shoqatave të Kosovës për të cilin ky kusht do të ishte i domosdoshëm, duke pasur parasysh që FNK-ja është një organizatë jofitimprurëse, e përbërë nga organizata profesionale të kontabilistëve. As vetë kushtetuta e FNK-së, e cila është akti themelor juridik i FNK-së, askund nuk përcakton se anëtarësimi në federatë është i detyrueshëm. Federata mbështet zhvillimin, miratimin dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe detyrimi për zbatimin e tyre parashikohet në Ligjin nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim,¹³ kështu që mund të konsiderohet se edhe pa anëtarësim në Shoqatat e Kontabilitetit dhe Auditorëve të Kosovës i përmbushin objektivat e FNK-së.
39. Vlen të theksohet se Ligji nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, i miratuar në përputhje me direktivat e mëposhtme të Bashkimit Evropian: Direktivën 2006/43/EC e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për auditimet ligjore të pasqyrave vjetore financiare dhe të pasqyrave financiare të konsoliduara, e datës 17 maj 2006; Direktivën 2008/30/EC e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për ndryshimin e Direktivës 2006/43/EC për auditimet ligjore të pasqyrave vjetore financiare dhe pasqyrave të konsoliduara, lidhur me kompetencat zbatuese dhënë komisionit, e datës 11 mars 2008; Direktivën 2013/34/EU e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për pasqyrat vjetore financiare, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet përkatëse të llojeve të caktuara të ndërmarrjeve, e datës 26 qershor 2013; Direktivën 2014/56/EU e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, për ndryshimin e Direktivës 2006/43/EC për auditimet ligjore të pasqyrave vjetore financiare dhe të pasqyrave financiare të konsoliduara, e datës 16 prilli 2014. Asnjë nga këto direktiva nuk përmban një dispozitë për anëtarësimin e detyrueshëm të një shoqate të kontabilistëve në MFF. Prandaj, konstatohet se vendosja

¹⁰ Po aty, neni 33, paragrafi 2.

¹¹ UA nr.03/2014, neni 20.

¹² Ligji nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 29, paragrafi 1, dhe neni 30, paragrafi 1.

¹³ Po aty, neni 4, paragrafi 3.

ligjore e anëtarësimit të detyrueshëm në MFF është në kundërshtim me dispozitat e ligjit të Bashkimit Evropian. Asnjë nga këto direktiva nuk përmban ndonjë dispozitë për anëtarësimin e detyrueshëm të një shoqate të kontabilistëve në FNK. Prandaj imponohet konstatimi se imponimi ligjor i anëtarësimit të detyrueshëm në FNK është në kundërshtim me dispozitat e ligjit të Bashkimit Evropian.

40. Aktualisht ekzistojnë tri shoqata profesionale në Kosovë të licencuara nga KKRF-ja: Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve Publikë të Çertifikuar (SCAAK), IKAF-i dhe Instituti AAB i Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar. Nga këto shoqata, vetëm një shoqatë (SCAAK) është anëtare e FNK-së së kontabilistëve, për çka dispozitat e lartpërmendura të Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim e vendosin në pozitë të privilegjuar krahasuar me shoqatat e tjera që nuk janë anëtare të FNK-së. Pozicioni i privilegjuar (i SCAAK-ut) i anëtarit të FNK-së reflektohet në faktin se anëtarësimi në FNK kërkon sponsorizimin e një shoqate që tashmë është anëtare, gjë që mund të çojë deri te vendimet arbitrare dhe si rrjedhim subjektet e tjera i vendos në pozitë të pabarabartë dhe të varësisë.
41. Avokati i Popullit thekson se legjislacioni kundër diskriminimit parasheh parimin e barazisë pa asnjë diskriminim, duke përfshirë diskriminimin në bazë të asociimit, kështu që është e rregulluar që të gjithë janë të barabartë dhe gëzojnë status të barabartë dhe mbrojtje të barabartë juridike, pavarësisht nga karakteristikat personale, prandaj secili është i detyruar ta respektojë parimin e barazisë, përkatësisht ndalimin e diskriminimit. Diskriminimi në bazë të asociimit nënkupton që palët e treta diskriminohen edhe pse nuk i përkasin një grupi të caktuar, por janë palët e treta që lidhen me ato grupe.
42. Në rastin konkret, shoqatat që nuk janë anëtare të FNK-së trajtohen në mënyrë më pak të favorshme se ato që janë anëtare të FNK-së. Anëtarësimi i detyrueshëm dhe kushtëzimi për vazhdimin e licencës me anëtarësim në FNK është një karakteristikë që diskriminon palët e treta joanëtare. Me zbatimin e një praktike të tillë, shoqatat që nuk janë anëtare të FNK-së diskriminohen pa arsye objektive dhe të arsyeshme, sepse ato trajtohen ndryshe për faktin se nuk janë anëtare të FNK-së, që është një karakteristikë përcaktuese që çon në trajtimin e tyre të pabarabartë dhe trajtimin e pabarabartë të anëtarëve e tyre, në raport me shoqatat që janë anëtare në FNK.
43. Me detyrimin për anëtarësim dhe trajtimin siç e rregullon ligji aktual licencimin e shoqatave që nuk janë anëtare të FNK-së vjen deri te diskriminimi i mijëra anëtarëve të tyre, të cilët tashmë janë të licencuar ose janë kandidatë për licencim dhe arsimim të vazhdueshëm profesional. Kjo do të thotë se në qoftë se atyre që nuk janë anëtarë të FNK-së do t'u hiqej licenca nga KKRF-ja, kjo automatikisht do të sillte revokim të licencave të anëtarëve të tyre dhe pamundësi për të punuar dhe kryer profesione.
44. Në rastin konkret, shoqatat profesionale të kontabilistëve dhe auditorëve diskriminohen pa arsye objektive dhe të arsyeshme dhe vihen në pozitë të pafavorshme në bazë të anëtarësimin në FNK-së. Nga ajo që u tha më sipër, futja e këtij kriteri nuk mund të pranohet si e justifikuar për shoqatat e kontabilistëve dhe auditorëve të Kosovës.

Konkluzioni

45. Duke pasur parasysh të gjitha ato që u thanë më sipër, Avokati i Popullit nxjerr konkluzionin se Ligji nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim i përcakton kompetencat e Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar (KKRF) për

- licencimin dhe mbikëqyrjen e shoqatave të kontabilistëve dhe të auditorëve profesionistë të Kosovës, që është parakusht për ushtrimin e profesionit të tyre.
46. Dispozitat e nenit 3, paragrafi 1, pika 1.13, dhe të nenit 33, pika 3, të Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim nuk janë në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe sigurisë juridike, sepse janë në kundërshtim me parimet kushtetuese të sundimit të ligjit dhe të mosdiskriminimit të përcaktuara me nenin 7 të Kushtetutës, lirinë e asociimit sipas nenit 44 të Kushtetutës dhe të drejtën për ushtrimin e profesionit sipas nenit 49 të Kushtetutës si dhe me parimet e Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
47. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi parasheh obligimin e trajtimit të barabartë të të gjithëve pa diskriminim, ndërsa sipas dispozitës së nenit 4, paragrafi 1, pika 1.7, lloji i trajtimit të pabarabartë është diskriminimi në bazë të asociimit. Përcaktimi i anëtarësimit imperativ për organizatat kosovare të kontabilistëve dhe auditorëve është trajtim i pabarabartë i shoqatave që nuk janë anëtare të kësaj federate bazuar në faktin e përkatësisë së tyre me FNK-në.
48. Avokati i Popullit konstaton se Shoqatat e Kontabilitetit dhe Auditimit mund të bëhen anëtare të FNK-së, por anëtarësimi duhet të jetë në baza vullnetare dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të imponohet si imperativ ligjor.
49. Avokati i Popullit thekson se kushtet për licencimin dhe ushtrimin e profesionit të kontabilistëve dhe të auditorëve duhet të jenë objektive dhe të barabarta për të gjithë dhe nuk duhet të lidhen me natyrën e anëtarësimit në një organizatë ndërkombëtare. Licencimi dhe ushtrimi i profesionit të kontabilistëve dhe të auditorëve duhet të jenë të qasshme për të gjithë qytetarët e kualifikuar në kushte të barabarta.
50. Prandaj Avokati i Popullit vlerëson se dispozitat e nenit 3, paragrafi 1, pika 1.13, dhe të nenit 33, paragrafi 3, të Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim janë kontradiktore dhe nuk përputhen me parimin bazë të ligjshmërisë, sigurisë juridike dhe respektimit të legjislacionit kundër diskriminimit.
51. Bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”* Në kuptim të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, ka përgjegjësi: *“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla; (...);”* si dhe të: *“Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.”* (neni 18, paragrafi 1.7).

Prandaj Avokati i Popullit i


REKOMANDON

- **Qeverisë së Republikës së Kosovës:**
 - **Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve:**

Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, përkatësisht fshirjen e nenit 3, paragrafi 1, pika 1.13, dhe të nenit 33, paragrafi 3.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,


Naim Qelaj

Avokat i Popullit